

Mundësitë origjinale hyrëse, gjithmonë zgjojnë interesimin e nxënësve!

Natyrisht se nuk kërkohen „barcoleta të mërziqshme“. Por një tregim i shkurtër me qëllim të mirë, i cili i përshtatet temës, është i mirëseardhur.

Gjithashtu me anë të ndonjë anekdote mund të vëni buzën në gaz / të qeshura tek nxënësi juaj.

Citate

Ju jeni një mjet i sprovuar retorik, i cili si në hyrje poashtu edhe gjatë mësimit, kujdeset për shumëllojshmëri (larmi).

„Kush pyet është budalla për pesë minuta, kush nuk pyet mbetet budalla përgjithmonë.“ - Fjalë e urtë kineze

„Njeriu së pari mëson të flasë, mëpas mëson ta mbyll gojën“

„Kush thotë A duhet të thotë edhe B. Ai mund ta zbuloj se A ka qenë gabim“

„Ne e kemi obligim, të mendojmë për pasojat e veprimeve tona“ - M. Gandhi

„Nuk jemi përgjegjës vetëm për atë që bëjmë por edhe për atë që nuk e bëjmë“ - Moliere

„Kush punon gabon. Kush punon shumë, gabon shumë. Kush nuk gabon avansohet (gradohet).“



Përjetimet dhe përvojat personale

Nuk duhet ti mërzisim nxënësit me problemet personale. Edhe ndërlidhja me temën nuk guxon të humbaset.

Mirëpo përvojat personale të ndërmjetësuar në mënyrë të drejtë në fillim të mësimit, mund të krijojnë atmosferë besimi dhe bindëse.

Mos filloni asnjëherë mësimin pa ndonjë hyrje. Vetëm udhëzimi mbi orën e fundit nuk mjafton! Plotësoni këshillat përmes ideve tuaja.

Si një domosdoshmëri në fillim të mësimit teorik / praktik mendoj se është përgatitja e pyetjeve të mira. Unë nuk ia lë rastit pyetjet e rëndësishme.

Me anë të pyetjeve të qëlluara, unë si mësime dhënë mund të zgjoj interesimin e nxënësit që ai të mendojë lidhur me ndonjë problem dhe të kërkojë zgjidhje të tij.

Mundësitë tjera

- Të përdoren mjetet ndihmëse dhe material për shiqim, demonstrimi i ndonjë ushtrimi, prezantimi i modeleve, mostrave
- Të dhënat dhe faktet aktuale
- Lajmet aktuale, njohuritë e reja
- Paraqitja e krahasimeve
- Pyetjet retorike